



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:280918

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524355

**C.nr.4864/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** me gjyqtaren Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.Ç.J. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokate S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilarë, vlera e kontestit 222.18 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **29.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditëses S.Ç.J. nga Prizreni.
- II. DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë pune, ti paguaj **shumën e përgjithshme prej 210.50 euro** apo 50 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 421.00 euro), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (datë 14.12.2023) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- III. REFUZOHET si e pa bazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit, lidhur me pagesën e pagës jubilarë dhe atë në shumën prej 11.68 Euro.
- IV. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124 euro**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja S.Ç.J. përmes të autorizuarës së saj av. S.M.N. pranë kësaj gjykate me datë 14.12.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë.

Në padi kanë theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek e paditura, e që duke llogaritur periudhën kohore ka arritur mbi 10 vite të përvojës së punës në këtë institucion, por të njëjtës nuk i është paguar paga jubilarë në bazë të përvojës së punës, e cila e drejtë i njihet në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021. Neni 35 par.8, pika 8.1 përcakton kompensimin e pagës jubilarë në bazë të përvojës së punës, duke filluar nga përvoja 10 vjeçare përkatësisht 50% të pagës dhe përcakton se pagën jubilarë punëtorit të arsimit ia paguan punëdhënësi i fundit, por që paditëses në momentin e arritjes së përvojës për shpërblimin jubilar nuk i është bërë pagesa e pagës jubilarë nga ana e të paditurës. Paditësja ka pagë bazë në lartësi prej 444.36 euro. Prandaj gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditëses, ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që tia paguaj paditëses shumën prej 228.18 Euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se përfitues të benificioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtar të sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.07/L-001. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëses është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i kanë kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës pranë Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit me numër 206/23, të datës 06.12.2023, të lëshuar nga ana e drejtorit të SHFMU “Shtjefën Gjeqovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, vërtetoi faktin se paditësja S.Ç.J. është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle nga data 01.09.2012 dhe vazhdon të punoj ende. Nga kontrata e punës e lidhur mes ndërgjyqësve u vërtetua se paditësja

është mësimdhënëse lëndore-gjuhë shqipe ndërsa nga lista e pagave u vërtetua se paga bazë mujore që paditësja realizon është 421 Euro.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj pasi këto vërtetime janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, gjykata i'a fali besimin e plotë, si prova me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe përvojën e punës për paditësen dhe lartësinë e pagës bazë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e datës 18.04.2017, përkatësisht e datës 22.01.2021. Me nenin 35 par.8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në shpërblim jubilar, në vitet jubilarë të punësimit nga punëdhënësi i fundit: dhe atë *“për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë; për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë...”*

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses S.Ç.J. është e bazuar pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), neni 35, par.8, pika 81.1 përkatësisht paditësja ka arritur 10 vjet përvojë pune pranë të paditurës me datë 01.09.2022, ndërsa lidhur me lartësi e aprovuar korrespondon me 50 % e pagës bazë mujore që realizon paditësja pranë të paditurës e që ka qenë në lartësi prej 421 euro, përkatësisht 210.5 Euro.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi shuma e kërkuar nga paditësja nuk paraqet llogaritje duke u mbështetur në pagën bazë, ashtu siç parashihet në dispozitat e kontratës, por llogaritja e shumës kërkuara është bërë duke iu referuar pagës neto që paditësja realizon dhe si e tillë shuma që ka tejkalluar pagën bazë është e pabazuar dhe u refuzua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe atë në shumën prej 11.6 Euro. Vendimin lidhur me pjesën refuzuese gjykata e mori duke u bazur në nenin 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*,

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2

të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (14.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, lidhur me pjesën aprovuese sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve dhe lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**  
**C.nr.4864/23 datë 29.03.2024**

**Gjyqtarja,**  
**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.